



Data: 20 nëntor 2012
Koha: 13:00-14:00
Vendi: Galeria Nazionale e Artit Çifte Hamam, Shkup
Tema: Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjeve të financimit IPA dhe hapja e ekspozitës së fotografive "Partnerë në Reforma"

**Fjalimi i Zj. Aleksandra Kas Granje, DREJTORE
DREJTORIA B KROACIA, MALI I ZI, ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E
MAQEDONISË, TURQIA, ISLANDA**

*I nderuar Zëvendës Kryeministër, Ministra, Ambasadorë
Mysafirë të shquar, Zonja dhe Zotërinj,*

Kam kënaqësi të veçantë që ndodhem këtu mes jush në galerinë madhështore Nacionale të Artit – Çifte Hamam, për të hapur ekspozitën tonë të fotografive "Partnerë në Reforma".

Kam nderin të jem këtu me Ministren Arif, e cila është një nga partnerët tanë kryesorë në reforma! Dialogu i Nivelit të Lartë për Anëtarësim ka nxitur vrullin real në procesin e reformave. Kjo është provë se partneriteti i Komisionit Evropian me vendin funksionon dhe po jep rezultate konkrete. Raporti i sivjetshëm i progresit ka reflektuar progresin e arritur në kontekst të dialogut të nivelit të lartë, dhe njëkohësisht ka theksuar sfidat që mbeten.

Vendi tregon në mënyrë aktive se është duke ecur drejt rrugës evropiane. Rrjedhimisht, për herën e katërt me radhë, Komisioni Evropian i ka rekomanduar Këshillit hapjen e negociatave të anëtarësimit. [Shpresojmë se Këshilli do të mund të reagojë pozitivisht në rekomandimin tonë.] Puna e lodhshme është pas nesh, por kemi punë të lodhshme edhe përpara nesh.

Ndihma financiare që ia sigurojmë vendit përmes Instrumentit për Para-Anëtarësim, afërsisht 100 milionë euro çdo vjet, luan rol të rëndësishëm në modernizimin e vendit, në zhvillimin e tij demokratik, dhe përgjithësisht në rrugën e tij drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian.

Evenimenti i sotshëm është rast për të treguar ndihmën e përgjithshme financiare të cilën BE-ja ia siguron vendit.

Përveç hapjes së kësaj ekspozite të mrrekullueshme të fotografive dhe me informata për projektet e suksesshme IPA, kam nderin të nënshkruaj tre marrëveshje të ndryshme financiare multi-milionëshe me Qeverinë.

Këto marrëveshje financiare do të sigurojnë ndihmë për një varg çështjesh të rëndësishme: një Program Nacional për ndihmën e ndërtimit institucional me vlerë prej 28.9 milionë euro, modifikimi i programit tonë aktual të ndihmës në fushën e bujqësisë me vlerë prej 65.5 milionë euro, nënshkrimin e marrëveshjes për financim 2011 për programin e bashkëpunimit ndërkufitar me Greqinë, me vlerë prej 1.5 milionë euro.

Më hollësisht, **Programi Nacional IPA 2011** do të sigurojë ndihmë në fushat në vijim:

- Reformat e Administratës Publike (3.6M €)
- Ndihma për Shoqërinë Civile (1.2M €)
- Përforcimi i Sundimit të Ligjit (2.4M €)
- Liria e të shprehurit – Përkrahja e Reformës së Mediave (1.5M €)
- Bankrotimi dhe falimentimi vullnetar i ndërmarrjeve (1.7M €)
- CAP – Përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative (2.5M €)
- Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale (1.4M €)
- Strehim për refugjatët, personat e zhvendosur dhe pakicat (3M €)
- Riforcimi i kapacitetit administrativ (10.5M €)
- Programet dhe Agjencitë e Unionit (4.6M €)

Programi i ndihmës nga DG AGRI, në fushën e **bujqësisë** do të vazhdojë të sigurojë ndihmë në fushat në vijim (kontributi i BE-së 2007–2012):

- Përmirësimi i efikasitetit të tregut dhe implementimi i Standardeve të BE-së (48,8M €)

- Implementimi i masave bujqësore-mjedisore dhe Lider1 (1.4M €)
- Zhvillimi i ekonomisë rurale (12.7M €)
- Ndihma e Përgjithshme Teknike (2.6M €)

Programi Ndër-Kufitar me Greqinë ka filluar që nga viti 2009 me vlerë të përgjithshme kumulative prej 6 milionë euro. Marrëveshja që e nënshkruajmë sot, do të financojë 6 ose 7 projekte të reja. Programi fokusohet në zhvillimin socio-ekonomik dhe rritjen e burimeve mjedisore, dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në rajonet e Pellagonisë, Vardarit, Juglindjes dhe Jugperëndimit nga njëra anë dhe rajonet greke të Selanikut, Florina, Pella, Kilkis dhe Serres nga ana tjetër e kufirit.

Kjo ekspozitë e fotografive është përpjekje për të bërë më vizuale për publikun ndihmën tonë për arritjen e synimeve. Përkrahja e publikut për "Projektin Evropian" të vendit është vitale. Perspektiva evropiane ka përparësi të qarta për të gjithë qytetarët. Një ekonomi më e fuqishme konkurruese, institucionet transparente demokratike, dhe marrëdhëniet e mira të këtij vendi me të gjithë fqinjët e vet janë synimet tona të përbashkëta. Shumë punë është bërë dhe shumë mbetet për t'u bërë.

Zonja dhe zotërinj,

Me këto fjalë përmbyllëse, ju falenderoj për vëmendjen.

- E N D -

¹ Iniciativa e Komunitetit Lider+ është pjesë e politikës së Komunitetit për zhvillim rural, shtylla e dytë e politikës së përbashkët të bujqësisë (CAP). Inkurajimi i implementimit të strategjive të integruara, me cilësi të lartë dhe origjinale për zhvillim të qëndrueshëm, ka fokus të fuqishëm në partneritetin dhe rrjetet e këmbimit të përvojave.